Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 595/13
Datë: 12.07.2013

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve bazuar në nenin 4 me pikat 1,3,6,9 dhe nenit 5 të pikave 1,2,3 të Rregullores së punës për Këshillin Drejtues të AKK-së, si dhe në mbështetje të nenit 14, 15, 16, 17 të kësaj rregullore, si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (nr. 03- L 0600), neni 10, neni 21.3 neni 22, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2011, miratuar nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritet Kombëtar i Kualifikimeve nxjerr:

VENDIM

1. Aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar;
2. Të bëhet dërgimi i një letre informuese donatorëve dhe palëve të interesit me listën e institucioneve të akredituara dhe kualifikimet e validuara me qëllim që të jenë prioritet në dhënien e donacioneve dhe përfitimeve tjera të mundshme;
3. Aprovohet lista e institucioneve aplikuese të cilat kanë aplikuar për validim të kualifikimit dhe akreditim në këtë fazë;
4. Aprovohet dhe lista dyvjeçare e ekspertëve të jashtëm për këto fusha:

   Nga Sektori i Ekonomisë

   1. Nëpunës/Nëpunëse e bankës, me kodin e klasifikimit 4122.03;
   2. Referent/Referente për eksport dhe import, me kodin e klasifikimit 3422.02;
   3. Referent/Referente (nëpunës/e) e kuadrove, me kodin e klasifikimit 3423.01;
   4. Nëpunës/Nëpunëse në statistikë, financa dhe të ngjashme, me kodin e klasifikimit

Nga sektori i Turizmit

1. Agjentë/Agjente turistike dhe e informimit për udhëtime, me kodin e klasifikimit 4221.01;

Nga sektori i makinerisë

1. Automekanik/Automekanike, me kodin e klasifikimit 7231.02;

Nga sektori i emergjencave

1. Zjarrfikës, me kodin e klasifikimit 5161.

4. Shtyhet shqyrtimi i kërkesës e MPMS për profilin e TIK derisa nuk sjellët në AKK në formatin e kërkesës zyrtare.
5. Aprovohet Draft- Udhëzimi mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë dhe t'i dërgohet zyrës ligjore për rregullim;
6. Aprovohet Draft- Udhëzimi Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak dhe t'i dërgohet zyrës ligjore për rregullim;
7. Aprovohet Draft- Rregullorja mbi kriteret dhe procedurat e verifikimit të standardeve të profesionit dhe t'i dërgohet zyrës ligjore për rregullim;
8. Udhëzimet administrative dhe Rregulloret që dalin nga Këshilli Drejtues duhet të nënshkruhen nga kryetari i Këshillit Drejtues të AKK.
9. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.
10. Vendimi të gjitha palëve të interesit

Kryetari i KD së
AKK-së
Ragip Gjoshi